Lezhë, më 23.09.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 23.09.2022, në orën 12:00, në Sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, për muajin Shtator 2022.

Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe 3 pikat shtesë.

Meqë z. Agostin Markun nuk është i pranishëm në mbledhje për arsye objektive, kryetari kërkoi që rendi i ditës të hidhet në votim pa pikën 1 të rendit të ditës (Interpelance) dhe me 3 projekt vendimet shtesë.

Rendi i ditës u miratua nga të gjithë këshilltarët prezentë, me ndryshimet e bëra.

Ndue Luli: Atëherë kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës të gjithnos që është projekt vendim "Për dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Gjon Ndoci".

Jeni njohur të gjithë me dokumentacionin e ardhur nga komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

E hedhim në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë. (21)

- Kryetari: fton z. Gjon Ndoci të ngrihet dhe lexon formulën e betimit të këshilltarit.
- Gjon Ndoci – Betohem.
- Ndue Luli – Suksese

Kalojmë te pika 3 që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-

ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Gusht 2022"
E hedhim në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (22)
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".
Meqë nuk ke diskutime rreth tij, e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (22)
- Erdhi këshilltarja Marta Sula.
- Ndue Luli: Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (Faza e dytë)".
Një sqarim këtu, kjo është faza e dytë, por në muajin tetor, Bashkia bashkë dhe me ne si këshilltarë do të organizojmë dëgjesa publike në njësitë administrative të bashkisë, për të kaluar te faza e tretë që është miratimi i plotë i buxhetit.
Ka kush diçka në lidhje me këtë pV?
Meqë nuk ke diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23).
Kalojmë te pika 6 që është projekt vendim "Për një shtesë dhe ndryshim në V.K. Bashkiak

nr. 177, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23).
Kalojmë te pika 7 që është projekt vendim "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024".
Meqë nuk ka diskutime e hedhim në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23).
Kalojmë te pika 8 që është projekt vendim "Për disa ndryshime në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024".
Ermal Pacaj: Ndryshimi që po bëhet aty është që Kryetari i Bashkisë ka menduar që t'i fokusojë shpenzimet në dy investime kryesore që kanë të bëjnë, njëri me shëtitoren e lumit Drin, gjithë pjesërisht të saj, deri te ura e trenit që i themi ne në Ishull Shëngjin dhe rehabilitimin e zonës aty, gjithashtu kangjellat do vendosen metalike, zëvendësimi i pllakave. Është në përfundim projekti i rehabilitimit të gjithë shëtitores në Shëngjin, që t'i japi jetë dinamikë edhe ndriçimit, edhe lulishte, gjithashtu do integrohen edhe disa lulishte te Vendvarrimi i Skënderbeut, që integrohet pastaj me projektin që po implementon Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Është bërë si procedurë,

po presin kontratën për ta implementuar në Bashkinë e Lezhës. Do bëhet pastaj lidhje edhe e shëtitores, edhe e atij projekti që është një projekt me fusha sportive dhe atraksione natyrore. Lezhës do i shtohet një park sportiv siç është dhe aneksi, një lulishte tjetër te vendvarrimi i Skëndenbeut ku sot është një kioske dhe i gjithë rregullimi i shtratit të lumit Drin. Do bëhet një transformim total i shëtitores së lumit Drin dhe zgjatja e saj në 200-300 m.
E dyta është rehabilitimi dhe rrugë e re në Tale. Do bëhet rruga e re për hyrjen në plazh sipas planit të përgjithshëm. Rruga prej te ura e deri te Hidrovori do bëhet me trotuar dhe ndriçim. Këto janë dy projekte kryesore që ne pretendojmë t'i implementojmë që këtë vit por efektshmërinë financiare të tyre ta kemi në vitin 2023 dhe 2024 sepse janë projekte që kushtojnë dhe buxheti i bashkisë nuk e përballon dot që t'i bëjmë të gjitha këtë vit. Kjo ka qenë arsyeja që financimi i vitit 2022 ka qenë jo më shumë se 6%.
Emirjon Lazri: Kemi vendosur disa prioritete për investimet, për asfaltimin e disa rrugëve rurale.
Ermal Pacaj: Për sa i përket kësaj, Bashkia e Lezhës ka bërë disa ndryshime në buxhet

me ndikimi në buxhetin afatmesëm. Kjo procedurë është zgjatur për shkak të një problematike që patën firmat konkurruese, që e zgjidhi APP. Dje është lidhur kontrata me firmën fituese dhe besoj që brenda tetorit të fillojnë rrugët e para.

Nduc Lulë: E hedhim në votim

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent (23) Kalojmë te pika 8 që është projekt vendim "Për normat e harxhimit të karburantit dhe mbajtjes në punë dhe në gadishmëri për mjetet e Bashkisë Lezhë".

Ermal Paca: Ne kemi bërë një investim kemi blerë ca automjete, kamioncina, makina për drejtorinë Pyjore, makina për drejtorinë e Shërbimeve dhe përderisa se janë mjete të çertifikuara për normat e harxhimit, del domosdoshmëri që ato të miratohen në këshill. Kjo bëhet që për konsumin e karburantit të ketë një përshkrim të fortë dhe të saktë.

Hasan Muça: Është gjë e mirë që flotës së mjeteve që ka bashkia, t'i shtohen mjete të reja, që kanë munguar për kohë të gjatë vërtetë. Ne jemi dëshmitarë që në kuadër të emergjencave civile, ne kemi çeduar shumë në këtë drejtim. Do kërkoja që kjo pjesë e shtimit të mjeteve, që siç kemi filluar, ta

vethdoni.

Ndue Luli: kush është dakord me projekt vendimin në tërësi?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë. (23)

Kalojmë te pika 10 që është projekt vendim "Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të rrugës nr. 03130037, në fshatin Pataloj, Njësia Administrative Kolsh, nga rruga "Papa Gjon Pali II", në rruga "Carmen Hernandez"".

Meqë është prezent, i japim fjalën kryetarit të Njësisë Administrative Kolsh.

Fatjon Zef: Carmen Hernandez ka dhënë një kontribut të madh në edukimin kulturor e fetar ndër breza. Fondacioni propozues ka dhënë kontribut të vyer për komunitetin, komuniteti i cili ka shprehur vullnetin për nderimin e saj, duke i vënë emrin e saj, rrugës në fshatin e tyre. Kjo rrugë që aktualisht kalon te dera e seminarit aktualisht ka emrin "Papa Gjon Pali II", por meqë edhe një rrugë në qytet e ka këtë emër, menduam që të vendoset aty.

Hasan Muça: Puna është që mos të krijohen pakënaqësi.

Fatjon Zef: E kanë kërkuar vetë.

Ndue Luli: Atëherë e kalojmë në votim.

Miratohet. Nga 23 këshilltarë prezentë, 22 votuan pro, 1 kundër (Anton Ndreu), 0 abstenim.

Një sporim për të fituar këshilltarët. Asnjë lloj emërtimi rruge, institucioni, titulli nderi, për nga korriku e në vazhdim, nuk mund të jepet nga ana jonë pa komunikim me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

E dyta, nuk do vëmë emra rrugësh pa konsultim nga ana e Këshillit Bashkiak me kryetarët e Fshatrave dhe kryetarit e Njësisë Përkatëse.

Për rastin e sotëm nuk ishte e nevojshme të bëhej shkresë për AIDISSH.

Kalojmë te projekt vendimi i pestë shtesë për çështjen "Për përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet përfituese në ndërtesat (pallatet) të rindërtuara pas "Tërmetit të 26 Nëntorit" në lagjen "Gurra"".

Ermal Pacaj: Do them diçka për emrat e rrugëve. Bashkia Lezhë e ka patur si politikë të saj për të pranojë propozime nga zonat, nga banorët. Në asnjë rast nuk ndodh për të jemi të kënaqur 100%.

Anton Ndreu: Të paktën ta kalojë 50%.

Ermal Pacaj: Sa i përket për në fjalë, është si rrjedhojë e një projekt vendimi tjetër, për këshilli i Bashkisë Lezhë ka marrë vendim për masën e përfitimit në bazë të individëve. Në bazë të akteve normative

nr. 5 dhe nr. 9, ne kemi ndarjen e banesave
për fqinjët, siç kemi bërë dhe në lagjen
"Besëlidhja" dhe për pallatin 88. Ne kemi
marrë vendim, i kemi shpallur përfituesit,
Në bazë të atij vendimi është bërë dhe
porosia e shtëpive. Fatmirësisht shtëpitë kanë
përfunduar dhe ne po bëjmë procedurën, që në
rastin më të keq ata të marrin çelsat të
paketën ditët e para të dhjetorit, në mënyrë
që këto shtëpi t'i përgatitin për Vitin e Ri.
Aty janë 80 objekte, nga të cilat 76 shpërndahen
me normë përfitimi në bazë të fqinjëve. Do
hidhet dhe shorti. Pastaj ngelin 4 familje
të tjera, të cilat as nuk kanë aplikuar, as
nuk bëhen të gjallë dhe nuk e dimë ku janë.
Por sipas verifikimeve që kemi bërë në kadastër
e kanë emrin dhe shtëpitë janë porositur edhe
për to. Kur t'u bjerë ndër mend atyre, sot,
nesër, mbas 10 vjetëve, shtëpitë atje prapë do jenë.
Me kalimin e vendimit sot dhe me konfirmimin
në Prefekturë, i hapim rrugë hedhjes së shortit,
që do hidhet kur çelsat të jenë gati. Pallatet
kanë arritur në 98% të punës dhe ambientet
e përbashkëta në një moment të dytë. Besoj se
nga data 10-15 tetor të hidhet dhe shorti
për ato banesa. Banesat ndahen sipas fqinjëve
që kanë pasur në certifikatën familjare. Pra,

në 76 banesat në "Gurrë", në fakt kemi
(familje)
5 apartamente të cilat kemi pasë shtëpi më
shumë se sa marrin. Kemi shtëpi që ishte më
e madhe, që ka pasë 74 m² dhe merr
shtëpi 1+1. sepse në bazë të normës së
përfitimit ashtu i bie. Procesi i rindërtimit
ka qenë proces i cili nuk ka qenë për të
bërë me shtëpi njerëzit që s'kanë shtëpi.
Ka qenë proces që me t'ba shtëpi, për të
futur kokën, për shtëpinë që të ka prishur tërmeti.
Dhe kjo nuk ka negocim fare. Ashtu sikurse
kemi mbi 40 raste që marrin shumë më shumë
se sa kanë pasë. Ligji kështu e thotë. dhe
te kjo pjesë nuk ndërhyjmë.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera,
e hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23).
Kalojmë te projekt vendimi i dytë shtesë që
është "Për një ndryshim në VKB nr. 161, dt. 02.12.2021
"Për miratimin e pagave të administratës së Bashkisë,
të njësive administrative, të institucioneve të varësisë,
të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së
shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve
të fshatrave për vitin 2022"".

Ermal Pacaj: Me vendim qeverie është rritur
paga minimale.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime e kalojmë

projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23)
Kalojmë te projekt vendimi i tretë shtesë dhe
i fundit për sot që është "Për përcaktimin
e vendit të asgjësimit dhe grumbullimit të
kadavrave të kafshëve në Bashkinë Lezhë".
I japim fjalën drejtorit të Bujqësisë në
Bashki z. Nikolin Prendi.
Nikolin Prendi: Përshëndetje të gjithëve
Siç e dini problemi i kafshëve endacake ose
pa pronar shpeshherë është bërë shqetësues
nëpër qytet sidomos gjatë periudhës së
sezonit turistik. Tani ka pasur përmirësim
sepse ky shërbim me ligj i ka kaluar bashkisë.
Por për të çuar deri në fund këtë shërbim,
ligji i jep kompetencë pushtetit vendor, që kafshët,
krahas trajtimit që do marrin (që bëhet
kapje, matrikullimi dhe gjithë shërbimi tjetër, ku
shumë janë pajisur me pasaportë dhe janë
adoptuar nga turistë të huaj) por ne kemi
detyrim ligjor që të përcaktojmë dhe një pikë
si vend groposjeje për të gjitha kafshët endacake
që janë pa pronar dhe për kafshët shtëpiake
që fermerë të ndryshëm ta kenë në rast se
iu ngordh kafsha. Ne e kemi gjetur vendin.
Është pronë e Bashkisë Lezhë, zonë pyjore, 50m$^2$.
dhe nuk ka asnjë efekt negativ në komunitet.

Menjëherë mbas miratimit nga ana juaj, kjo do i kalojë për administrim Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë, që do menaxhojë gjithë procesin.

Hasan Muça: Keni bërë një punë shumë të mirë ju për kafshët e rrugës, për matrikullimin. A do ketë një qendër grumbullimi të këtyre kafshëve?

Nikolin Prendi: Operatori që ka fituar tenderin i merr të gjitha këto kafshë (qen e mace) dhe kryen matrikullimin, trajtimin, vaksinimin.

Ndue Luli: E kalojmë projekt vendimin në votim. Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (23).

Kalojmë te pika të ndryshme.

- Këshilltarja Meri Malotaj diskutoi në lidhje me Qendrën shëndetësore në fshatin Gocaj ku mungojnë një tualet dhe një lavaman për stafin mjekësor.
- Këshilltari Vidar Alia diskutoi në lidhje me investimin që pritet të bëjë KFW gjermane në lagjen Kodër Marlekaj dhe faktin që ujë është me orar shumë të reduktuar elektricitet.
- Ndue Luli: Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI